

# BULETINI INFORMATIV



Gjatë muajit prill, ERE ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë së saj rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi licencimet e reja, publikimet, të dhënat e tregut, çmimet e shitjes së energjisë elektrike si dhe dokumentet/aktet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik.

Synimi ynë mbetet garantimi i transparencës, rritja e eficiencës dhe mbështetja e zhvillimit të tregut të energjisë në vend.

Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)

## LICENCIME

### Procedura të filluara gjatë muajit prill 2026

Gjatë muajit prill, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka filluar procedurat për licencimin e shoqërive si vijon:

“KOKA & ERGI ENERGY PESHK” shpk veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe “SPV Blue 3” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik “Blue 3”, me kapacitet të instaluar 36 MWac, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 30 vjeçar.

### Vendime fillim procedure modifikim licence

Po ashtu, Bordi i ERE-s, ka filluar procedurat edhe për modifikimin e licencave në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për shoqërisë “SPV Blue 2” shpk, “SPV BLUE 1” shpk, “Erseka Solar Park 2 shpk dhe “Erseka Solar Park 1” shpk, për i përket shtimit të veprave ndihmëse/njësisive të depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjensia Kombëtare e Mjedisit si dhe Operatori i Sistemit të Ttransmetimit sha.

### Vendime fillim procedue transferim licence

Po ashtu, ka filluar procedurën edhe për transferimin e plotë të licencës dhënë shoqërisë “DRINI BULQIZË” shpk me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.04.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, te shoqëria “HEC Polemi” shpk. Ky vendim i është njoftuar shoqërive, si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithashtu, për aplikimet e mësipërme, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

### Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit prill

Gjatë muajit prill 2026, Bordi i ERE ka zhvilluar 5 mbledhje vendimmarrëse për të cilat është bërë njoftimi të paktën 24 orë përpara edhe në rrjetet sociale të institucionit, duke ftuar të gjitha palët e interesit të ndjekin mbledhjet online. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 27 vendime, që përfshijnë: fillimin e procedurave të reja të licensimit; licensime; autorizime; pezullim apo zgjatje të afateve vendimmarrëse; modifikim licence si dhe miratime të çmimeve dhe tarifave të ndryshme. Një përmbledhje e vendimmarrjes së Bordit është publikuar pas çdo mbledhje në rrjetet sociale. Ndërsa vendimet e plota gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë [vendimet](#) si dhe në Fletoren Zyrtare.

# BULETINI INFORMATIV



## Vendime licencimi

Gjatë muajit prill 2026 Bordi i ERE-s ka vendosur të licencojë shoqërinë “DION Energji” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MË, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar, Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.05.2026. Po ashtu është vendosur edhe licensimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

## Vendime modifikim licence

Bordi i ERE-s gjatë muajit prill, ka vendosur modifikimin e licencave të prodhimit, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencave repsektive ,përkatësisht për shoqërinë “EZ-5 ENERGY” shpk, për licencën e dhënë me vendimin e Bordit nr. 237, datë 22.09.2022 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, duke shtuar objektet e depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar, për licencën e dhënë me vendimin e Bordit nr. 171, datë 31.07.2025 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW, për shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit, si dhe për shoqërinë , “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk për licencën e dhënë me vendimin e Bordit nr.242, datë 03.08.2023 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MË, për ndryshimin e numrit të paneleve dhe shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

## Vendime ndryshim vendimmarrjeje

Gjatë muajit prill, në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit përkatës të licencimit, Bordi i ERE-s ka vendosur të ndryshojë vendimnr. 193, datë 18.09.2024 Për licencimin e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimin nr. 46, datë 17.02.2026, Nga korrespondenca me shoqërinë ka rezultuar se shoqëria ka kryer njoftimin për testimin e impiantit duke dëshmuar gatishmërinë për fillimin e prodhimit brenda afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të ERE-s. Po ashtu shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e AKBN-së datë 06.03.2026, me të cilën është përcjellë Raporti i Testimit i impiantit FV “HPG ENERGY” (2 MW), i kryer në terren nga grupi i punës. Sipas këtij raporti, testimi është zhvilluar në datat 26–27.01.2026. Si e tillë, u vlerësua se shoqëria ka përmbushur kushtet e percaktuara në vendimin e licensimit

Për rinovimin e licencës së shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”; në kushtet që shoqëria ka depozituar kontratën e qirasë të rinovuar. Po ashtu është vendosur edhe për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin nr. 262, datë 21.10.2025 “Për licencimin e shoqërisë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.Pasi u konstatua se shoqëria ka depozituar në ERE marrëveshjen e shërbimit për ofrimin e shërbimeve IT dhe stafit teknik-administrativ, duke plotësuar kështu detyrimet që burojnë nga vendimi nr. 262/2025, i ndryshuar.

## Heqje licence

Bordi i ERE-s, ka vendosur të heqë licencën dhënë shoqërisë “ENERGY MARKET ALBANIA” shpk, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak të mosshlyerjes së pagesës rregullore.

# BULETINI INFORMATIV



## Vendime për zgjatje të afatit të vendimmarrjes

Bordi i ERE-s, gjatë këtij muaji, po ashtu, ka marrë vendimet përkatëse për zgjatjen deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjes, me qëllim për të plotësuar informacionin/dokumentacionin e aplikimit, përkatësisht për shoqërinë “ELENERGJI” sh.p.k (për aplikimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrikenga Hec “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kË, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.); “PROSOL” sh.p.k (për aplikimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.); “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” shpk, (për aplikimin licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrikenga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier; “GSA” shpk (për aplikimin për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike); “Sunny Side Energy” shpk, (për aplikimin licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

## REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, si dhe me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (Regjistri REMIT). Për vitin 2026, numri total i shoqërive të regjistruara në regjistër është 99. Përgjatë muajit prill janë regjistruar 5 subjekte, respektivisht shoqëritë: “GSA Energy” sh.p.k., “Vivid Power” sh.p.k., “SLR ALBANIA” sh.p.k., “MET Albania” sh.p.k. dhe “Interenergo D.o.o. - Kosovë, Degë e Shoqërisë së Huaj”. Ky regjistër gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen zyrtare të ERE-s: [remit.ere.gov.al](http://remit.ere.gov.al).

## AUTORIZIME PËR GARANCI FINANCIARE

Gjatë muajit prill 2026, Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për dhënien e autorizimit shoqërisë “DRINI BULQIZË” shpk për transferimin e aseteve fikse të saj, tek shoqëria “HEC Polemi” shpk.

Po ashtu, gjatë këtij muaji, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesat për marrje autorizimi si më poshtë vijon:

### Transferim asetesh

Bordi i ERE-s, ka vendosur të japë autorizimin shoqërisë “Sunny Side Energy” shpk për transferimin të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sha.

### Ndryshim ortakut

Bordi i ERE-s ka vendosur të japë autorizimin shoqërisë “SUN BEAT SYSTEM” shpk për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

### Vendime zgjatje vendimmarrje

Bordi i ERE-s ka vendosur të shtyjë deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” shpk, për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.


Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

## GARANCITË E ORIGINËS

Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë 2 (dy) kërkesa për krijimin e llogarive në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, për tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike, për shoqëritë “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” shpk dhe “ReNRGY Trading Group” shpk.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë.

# BULETINI INFORMATIV



## TREGU I ENERGJISË

Kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë gjatë muajit mars i është shtuar një central fotovoltaik i pozicionuar në zonën e Fierit, Njësia Administrative Topojë me kapacitet total të instaluar prej 2 MW, i cila operohet nga shoqëria “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k duke zotëruar kontratë shitblerje energjie me “FTL” sh.a. me çmim të rregulluar.

Muaji mars ka vijuar të përmirësojë kapacitetin prodhues të Kaskadës së Drinit. Prodhimi neto i realizuar nga HEC-et e Kaskadës së Drinit për këtë muaj është 466,467 MWh ose rreth 38% më shumë energji elektrike e prodhuar se muaji mars i vitit të kaluar. Niveli i liqenit të Fierzës i cili është bazeni kryesor në kaskadën e lumit Drin në fillim muaji arriti kuotën prej 293.42 mmnd ndërsa fundi i muajit u mbyll në nivelin 292.01 mmnd. Sikurse evidentuar përgjatë këtij muaji kemi zbritje të nivelit të ujit në liqenin e Fierzës prej rreth 1.41 metër. Prurjet mesatare mujore në këtë liqen rezultuan 200 m<sup>3</sup>/sek ndërsa rezerva energjitike për kaskadën e Drinit në fund të muajit mars rezultoi 1273.7 GWh.

Përgjatë këtij muaji shoqëria publike “KESH” sh.a. nuk ka pasur shkarkime pa prodhim energjie nga portat e HEC-eve në kaskadë si dhe nuk ka kryer procedura blerjeje energji elektrike në treg të parregulluar sipas detyrimit për shërbimin publik të vendosur në VKM 456/2022, e ndryshuar.

Prodhimi total neto vendas për muajin mars u përlogarit 1,020,589 MWh ose rreth 33% më shumë energji elektrike e prodhuar se periudha korresponduese e vitit të kaluar ku kontribuesit kryesorë kanë qenë centralet hidrike me 90% dhe centralet fotovoltaike me 10%.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për muajin mars rezultoi 260,624 MWh (dalje), si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 451,039 MWh dhe importit të realizuar në vlerën 190,415 GWh.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike për këtë muaj arrijnë në 18.54%, ndërsa ato të sistemit të transmetimit në vlerën 1.55 %.

Në të gjitha tregjet e ALPEX-it gjatë muajit mars u tregtuan gjithsej 174,315.71 MWh energji elektrike, ndërsa rrjedha ndërkufitare arriti në 56,622.97 MWh. Në Tregun e Ditës në Avancë u tregtua një volum total prej 165,316.69 MWh energji elektrike, me një çmim klerues mesatar prej 96.89 €/MWh ndërsa në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë u tregtua gjithsej 8,999.02 MWh me një çmim mesatar ditor klerues prej 90.60 €/MWh. Numri i Anëtarëve të Bursës ishte 43, të cilët morën pjesë në Tregun e Ditës në Avancë, ndërsa 30 prej tyre edhe në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë. Numri i Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit arriti në 6. Gjithashtu përgjatë muajit mars ALPEX regjistroi një anëtar të ri në Tregun e Ditës në Avancë si dhe në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë, respektivisht shoqërinë NAD Investment sh.p.k. për zonën e ofertimit të Shqipërisë.

# BULETINI INFORMATIV

## VENDIME PËR ÇMIMET DHE TARIFAT

### Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e datës 09.04.2026 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2026, në vlerën 14.00 Lekë/kËh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Ky çmim rezulton më i lartë krahasuar me muajin shkurt 2026, i cili ishte 9.56 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, koston e rrjetit dhe koston administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhajtjen është kosto e energjisë së blerë. Për muajin mars 2026, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 10.23 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 160.63 MWh. Ndërkohë, për muajin shkurt 2026, kosto përkatëse ka rezultuar 5.92 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 100.86 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin mars 2026 është rritur rreth 72.8% në raport me muajin shkurt 2026, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është rritur rreth 59%. Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kËh, siç është miratuar nga ERE në muajin shkurt 2026. Ky çmim mbetet fikso, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

### Tarifat e përkohshme të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 Maj - 31 Dhjetor 2026

Në mbledhjen e datës 14.04.2026, Bordi i Enti Rregullator i Energjisë, me vendimin nr. 103, miratoi tarifat e përkohshme të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën 1 maj - 31 dhjetor 2026, pas analizimit të treguesve financiarë dhe teknikë të paraqitur nga OSSH sh.a. për periudhën 2022-2026. Analiza e kryer mbi të ardhurat e kërkuara, energjinë e shpërndarë dhe realizimin e treguesve teknikë e ekonomikë tregoi se tarifa mesatare e shpërndarjes për vitin 2026 mbetet në nivelin 5.89 lekë/kWh. Mbi këtë bazë, u përcaktuan tarifat sipas niveleve të tensionit: 1.55 lekë/kËh për klientët 35 kV, 3.99 lekë/kWh për klientët 0.6/20 kV dhe 6.42 lekë/kWh për klientët 0.4 kV. Gjithashtu, u miratua çmimi prej 1.92 lekë/kVArh për energjinë reaktive.

### KONSULTIME

Në mbledhjen e Bordit të datës 14.04.2026, u relatua informacion mbi vijimin e procedurës për vlerësimin nga ERE të gatishmërisë së tregut të ditës në avancë në Shqipëri. Në këtë kuadër, në rubrikën “Konsultime” të faqes zyrtare të internetit të ERE-s është publikuar për konsultim drafti “Vlerësimi i ERE-s për Gatishmërinë e Tregut të Ditës-në-Avancë në Shqipëri”, publikuar më datë 15.04.2026 të cilin mund ta shfletoni në linkun: <https://ere.gov.al/sq/publikime/konsultime/vleresimi-i-ere-s-per-gatishmerine-e-tregut-te-dites-ne-avance-ne-shqiperi-draft>

### Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit prill është përditësuar informacioni në ëebin e ERE-s [www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al) dhe rrjetet sociale me [vendime](#), [njoftime të mbledhjeve](#), [njoftime mbi aplikime të reja për licencim](#) si dhe [çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2026](#).

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))